

VENDIM
Nr. 81, datë 28.1.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 241, DATË 31.3.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRYERJEN, NGA “POSTA SHQIPTARE” SHA, TË
SHËRBIMEVE POSTARE, FINANCIARE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA, QË JANË
NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E KËSAJ POSTE, PËR INSTITUCIONET E
QEVERISJES QENDRORE E VENDORE, INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE SI
DHE SHOQËRITË TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titull dhe në pikën 1, të vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, hiqen fjalët “... si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror...”.

2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama